

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Video Syri TV - Viti i ri shkollor, tkurret numri i nxënësve, shpopullimi zbraz klasat! Në Tiranë 20 shkolla v azhdojnë mësimin me turne
ADRESA	https://www.syri.net/sociale/916578/viti-i-ri-shkollor-tkurret-numri-i-nxenesve-shpopullimi-zbraz-klasat-ne-tirane-20-shkolla-vazhdojne-mesimin-me-turne/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 13:49:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 13:44:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b79c343e9c378980e66a906e185fa0684b881eb8d2e9b726d2c1c344e94fa25b
TEKSTI	ef83d627f3726bb9aae4513220349abe25d0a814f1a2386bdbc2fdda030ad5e
PAMJA	dcd0097dc6666fed113db6c7bfa33e77b2b8e72b2ad6f33d3192fb550134afd5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fa763933363bddd09080ff5865cdd4c0eace0a9d564794ee840197ba3bb0a01f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6e410cf6c3be6bd40f75161c1288a8066fcd1b6e7ab80a3c789507dd842f2954
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fa763933363bddd09080ff5865cdd4c0eace0a9d564794ee840197ba3bb0a01f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën



më të lexuarat

Protestë kundër bllokimit të rrugës 200-vjeçare/ Banorët: Duan t'na marrin jetën! Kalaja: Fushë-Kruja ndahet përgjysmë

SYRI TV/ Pas ngujimit në zyra, Bankers tërhiqet, banorët arrijnë marrëveshje me firmën

Horoskopi, 13 shtator/ Zbulohet çfarë parashikojnë yjet për secilën shenjë

Këshillat e ekspertëve: 5 gjëra që nuk duhet t'i ndani me ChatGPT

Shqipëria po përballlet me çmime ushqimore më të shtrenjta se mesatarja europiane! TVSH-ja, ndër më të lartat në BE

'Viti i ri shkollor nis në një mjedis të polarizuar social'/ Sindikata e Arsimit: Politikat arsimore, të pa mjaftueshme



Viti i ri shkollor, tkurret numri i nxënësve, shpopullimi zbraz klasat! Në Tiranë 20 shkolla vazhdojnë mësimin me turne

15:44, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Viti i ri shkollor ka nisur, por numri i nxënësve po tkurret nga viti në vit. Mungesa e nxënësve në zonat rurale ka sjellë mbylljen e disa shkollave, shkrirjen e klasave dhe përqendrimin e nxënësve në qendrat urbane. Në Tiranë, 20 shkolla vijojnë mësimin me turne, ndërsa në qarqet e Fierit, Vlorës, Korçës, Elbasanit e Gjirokastrës, rënia e numrit të nxënësve po bëhet gjithnjë e më e dukshme, teksa shumë shkolla rrezikojnë mbylljen ose funksionojnë me numër minimal nxënësish. Shifrat e INSTAT tregojnë se ka rreth 30.500 nxënës më pak në arsimin parauniversitar në tre vitet e fundit.

SYRI TV

Kjo e hënë e 14 shtatorit shënoi fillimin e vitit të ri shkollor për arsimin fillor dhe atë të mesëm. Në të gjitha qytetet e vendit nxënësit iu drejtuan bankave të shkollës në institucionet e arsimit 9-vjeçar dhe gjimnazëve. Numri më i madh i nxënësve mbetet i përqendruar në kryeqytet, teksa edhe për këtë vit shkollor, në Tiranë 20 shkolla do të zhvillojnë mësimin me turne për shkak të numrit të ulët të shkollave dhe imigrimit të brendshëm.

Ndërsa në zonat rurale të vendit, mungesa e nxënësve ka sjellë shkrirjen e klasave si dhe mbylljen e shkollave. Në qarkun e Fierit, shpopullimi i zonave rurale dhe lëvizjet demografike kanë sjellë mbylljen e kopshteve dhe shkollave të vogla, ndërsa në disa zona shkollat 9-vjeçare dhe të mesme funksionojnë si shkolla të bashkuara, duke mbledhur nxënës nga disa fshatra përreth. Edhe pse në Fier këtë vit është shënuar një rritje e lehtë e numrit të nxënësve të regjistruar, vihet re një tendencë për përqendrimin e arsimit të mesëm, ku nxënës nga zona e Levanit, Qarrit, Boçovës, Frakullës, Semanit, Darzezës dhe zonave të tjera po orientohen drejt shkollave të mesme në qytetin e Fierit.

Në Mallakastër, shkolla e bashkuar e Fratarit mbledh nxënës nga fshatrat Drizar, Damës, Gadurovë, Kremenar, Corrush, Kut, Bejar dhe zona të tjera përreth. Në Bashkinë Mallakastër, janë bashkuar shkollat për nxënësit e zonave Fratar, Aranitas e Ballsh, të cilët janë orientuar drejt shkollave të përqendruara në qendër.

Fenomeni është i dukshëm edhe në Bashkinë e Roskovecit dhe Patosit, ku numri i nxënësve të regjistruar ka pësuar rënie. Si në klasat e para, ashtu edhe në

arsimin 9-vjeçar dhe atë të mesëm.

Edhe në qarkun e Vlorës, është shënuar rënie e numrit të nxënësve. Në Selenicë nuk do të hapet shkolla e Lapardhasë pasi është regjistruar vetëm një nxënës. Dy shkolla 9-vjeçare, "Marigo Posio" në Vlorë dhe "Pano Nikolla" në Himarë nuk kanë hapur dyert, pasi janë në rikonstruksion. Edhe në Qarkun Gjirokastrë, në Këlcyrë, një shkollë nuk hapet për shkak të mungesës së plotë të regjistrimeve, teksa një gjimnaz në Bashkinë Libohovë rrezikon mbylljen për shkak të numrit shumë të ulët të nxënësve.

Edhe në qarkun juglindor ka rënë numri i nxënësve. Në bankat e klasës së parë këtë vit në qarkun e Korçës janë ulur 3.7% më pak nxënës, krahasuar me vitin e kaluar. Brenda vetëm një viti, sistemi arsimor i qarkut numëron 680 nxënës më pak, një rënie prej rreth 3.6%. Të dhënat e këtij fillimviti shkollor konfirmojnë se numri i nxënësve në qarkun e Korçës po tkurret.

Edhe në qarkun e Elbasanit këtë vit janë regjistruar më pak nxënës se një vit më parë. Në Prrenjas, Cërrik e Belsh vihet re rënia më e madhe e numrit të nxënësve.

Në qarkun e Durrësit, disa shkolla nuk kanë hapur dyert. Një prej tyre është shkolla 9-vjeçare "Bajram Curri", ku punimet për rikonstruksion vijnë ende. Për të shtatin vit radhazi, nxënësit e gjimnazit "Gjergj Kastrioti" do t'i zhvillojnë mësimet në shkollën pritëse "Marie Kaçulini", ndërsa rreth 70 nxënës të shkollës së Filakës janë transferuar pranë shkollës "Artan Zeka" në Qerret.

Pavarësisht kësaj panorame, dita e parë e shkollës ngjall emocione të veçanta për nxënësit, të cilat ndanë përjetimet e tyre këtë fillimviti të ri shkollor.

Shifrat tregojnë se Shqipëria po përballet me një krizë të thellë demografike, ku çdo vit regjistrimi i nxënësve në shkolla ka shënuar rënie të vazhdueshme. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin shkollor 2025–2026, vetëm arsimi 9-vjeçar ra me 2.7%, ndërsa arsimi i mesëm me 0.4% krahasuar me vitin paraardhës. Për 3 vite përlllogariten rreth 30,500 nxënës më pak në arsimin parauniversitar, duke shënuar një rënie afërsisht 8.4% në vetëm tre vite.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Viti i ri shkollor nis në një mjedis të polarizuar social'/ Sindikata e Arsimit: Politikat arsimore, të pa mjaftueshme



Protestë kundër bllokimit të rrugës 200-vjeçare/ Banorët: Duan t'na marrin jetën! Kalaja: Fushë-Kruja ndahet përgjysmë



Dita e parë e shkollës në Kavajë, kryebashkiaku Fisnik Qosja mesazh urimi për të gjithë nxënësit

Brenda kolapsit të agjencisë së surrogacisë që u kushtoi grave surrogate dhe prindërve të ardhshëm ëndrrat e paratë e tyre

VIDEO/ Elbasan, tension në Këshillin Bashkiak, opozita: Fondi i emergjencave nuk po përdoret nga mungesa e planifikimit

Viti i ri shkollor, tkurret numri i nxënësve, shpopullimi zbraz klasat! Në Tiranë 20 shkolla vazhdojnë mësimin me turne

TË NGJASHME



Vlonjatët po ikin nga Vlora/ Më pak nxënës në klasën e parë, në bankat e shkollës dhe fëmijë ukrainas




Pesimizmi, dashuria dhe paratë – Ja çfarë kanë rezervuar yjet në këtë 14 shtator



Numri i nxënësve në qarkun e Korçës po tkurret/ Këtë vit gati 700 më pak në bankat e shkollës



Berati po boshatiset/ Bie ndjeshëm numri i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, dhe ata që hyjnë në klasën I



Shpopullimi në qarkun e Elbasanit/ Viti i ri shkollor nis me më pak fëmijë në bankat e klasës së parë



Shpopullimi në Gjirokastrë/ Më pak nxënës në klasën I - Në zonat rurale klasa kolektive, ose vetëm me 1 fëmijë



Shpopullimi/ Në qarkun e Fierit më pak nxënës në banka! Shkollat në periferi e ato rurale drejt boshatisjes



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.